Breaking News: Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm, gjatë aktivitetit me gjimnazistët, për sigurinë në shkolla
Dibër – Cënoi sigurinë publike nga përdorimi pa kriter i lëndëve piroteknike, në orët e mesnatës, procedohet penalisht 28-vjeçari
PKK Rinas – Finalizohet operacioni policor i koduar "Skanimi"
Peqin – Finalizohet pas një hetimi disajavor, operacioni policor i koduar "Katërkëndshi"
Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, gjatë 24 orëve të fundit

Lajmet | Operacionet

21/06/2024

PKK Rinas – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Skanimi"

PKK Rinas/Intensifikimi i kontrolleve, parandaloi një tentative për të trafikuar armë zjarri nga Shqipëria në Itali

Finalizohet operacioni policor i koduar "Skanimi". Sekuestrohet 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak.

Arrestohet në flagrancë poseduesi i armës (shtetas kosovar).

Si rezultat i kontrolleve të dedikuara, bazuar në analizen e riskut dhe në informacionet e inteligjencës policore, të intensifikuara për shkak të fluksit në hyrje/dalje, shërbimet e Policisë Kufitare të PKK Rinas, në bashkëpunim me shërbimet e Sigurisë në aeroportin e Rinasit, finalizuan operacionin policor të koduar "Skanimi", në kuadër të të cilit u godit një tentativë për të trafikuar armë zjarri nga Shqipëria në Itali.

Gjatë këtij operacioni u kap në flagrancë dhe u vu në pranga, në dalje të Shqipërisë, shtetasi kosovar D. G., 23 vjeç, banues në Pejë.

Nga kontrolli nëpërmjet skanerit, në çantën e këtij shtetasi, u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Trafikimi i armëve dhe i municionit".





Peqin – Finalizohet pas një hetimi disajavor, operacioni policor i koduar "Katërkëndshi"

Dibër – Cënoi sigurinë publike nga përdorimi pa kriter i lëndëve piroteknike, në orët e mesnatës, procedohet penalisht 28-vjeçari

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent